



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRES

Nr. 1475 Prot

Durrës 26.06 2024

**SHPALLJE E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PËR DREJTUES NË
INSTITUCIONE ARSIMORE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 55 të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 1, nenit 2 dhe nenit 3 të Udhëzimit Nr. 22, datë 13.11.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”

1. Shpallen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues institucioni arsimor në institucionet arsimore publike, sipas tabelës bashkëlidhur.

Nr	Drap	Zvap	Bashkia	Emri i Shkollës në SMIP	Shkolle Qendër	Lloji i shkolles
45	Durrës	Tiranë	Tiranë	Kongresi I Lushnjes	Qendër	AMU
46	Durrës	Tiranë	Tiranë	Osman Myderizi	Qendër	AMU

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për pozicionin drejtues institucioni publik arsimor parauniversitar :

- Të zotërojë arsimimin si mësues sipas përcaktimeve të nenit 57 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” me vlerësim jo më pak se “Mirë” në kualifikimin fundit.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi ndaj tij.

Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në institucionin publik arsimor parauniversitar;



- Jetëshkrimin (sipas modelit në shtojcën nr. 1 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”);
- Kopje e librezës së punës;
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID);
- Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5 të udhëzimit);
- Certifikatën e drejtuesit të IPAP-së ose vërtetim nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor, në rast se e disponon;
- Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcë nr. 2 të udhëzimit);
- Vërtetim nga institucioni ku punon, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Deklaratën për verifikimin e vërtetësinë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati sipas shtojcës 8, të udhëzimit.
- Deklaratën e konfliktit të interesit të aplikantit me punonjësit arsimorë të IPAP-së, (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prind të bashkëshortit/es) (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3 të udhëzimit).

Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet nëpërmjet **shërbimit postar ose në rrugë elektronike në adresën e ZVAP që mbulon institucionin arsimor ku është shpallur vendi vakant.**

Dokumentacioni dorëzohet brenda datës 05.07.2024 (brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes).

Komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit mblidhet jo më vonë se tri ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit, për të bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit.

Komisioni shqyrton dokumentacionin për mangësi brenda dy ditëve pune dhe njofton me shkrim ose e-mail kandidatin që ka mangësi në dosje.

Kandidati nga momenti i njoftimit, ka tre ditë pune kohë për të dorëzuar dokumentacionin që mungon.

Pas përfundimit të këtij afati, komisioni shpall listën me kandidatët që kanë dokumentacionin e plotë dhe të saktë, bën vlerësimin e dosjeve si dhe realizon intervistën e strukturuar brenda një ditë pune.

Komisioni harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës dhe brenda tri ditëve pune shpall në këndin e njoftimeve të IPAP-së tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 7, bashkëlidhur Udhëzimit.

Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankime me shkrim para Komisionit brenda tri ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune.

Në rast se nuk konstatohen probleme procedurale, drejtori i ZVAP brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell në DRAP dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë.

Drejtori i DRAP realizon intervistat brenda 5 ditëve pune nga momenti i marrjes dijeni të dy kandidatëve me më shumë pikë.

Brenda tri ditë pune, nga realizimi I intervistës me kandidatët, drejtori i DRAP shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP-së.

Kandidati jofitues ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda tri ditë pune në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Kandidati ankimues merr përgjegje nga Ministria e Arsimit dhe Sportit brenda 10 ditëve pune pas mbarimit të afatit të ankimit.

Bashkëlidhur këtij njoftimi do të gjeni vendet vakante për pozicion drejtor IAP Publik.

DREJTOR I DRAP

Hazbi LIKA

